**SKEMA E VLERËSIMIT TË PROVIMIT TË MATURËS NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, JANAR 2017**

1. Është rrethuar numri 2. traseja e rrugës dhe orari i udhëtimeve - ***1 pikë***

2. Nxënësi/nxënësja* merr – ***1 pikë*** nëse shkruan: *autobusi niset në orën 6/në orën 06:00/në gjashtë*

3. Është rrethuar numri 3. Stacioni Bulevardi Stanko Dragojeviq - ***1 pikë***

4. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse përshkruan ose perifrazon tekstin: *"Stacioni i autobusit në aeroport ndodhet para terminalit të ndërtesës."/Para terminalit të ndërtesës. (dhe përgjigje tjera të sakta)*

5. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse përshkruan ose perifrazon tekstin: *"Autobusët janë të ulët me rampa të përshtatshme për karrocat e fëmijëve dhe personat në karrocat e invalidëve." /Janë të përshtatur për nënat me fëmijë në karrocë dhe për invalidët (dhe përgjigje tjera të sakta)*

6. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse përshkruan ose perifrazon tekstin: *"Ka rreth 1500 njerëz të shquar nga e gjithë bota që me zbulimet dhe shpikjet e tyre dhanë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e shkencës. "/Rreth 1500... (dhe përgjigje tjera të sakta)*

7. Është rrethuar numri *1. SHBA* - ***1 pikë***

8. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: *Sepse punimet e tij kanë kontribuar që të gjendet ilaçi kundër tuberkulozit... (dhe përgjigje tjera të sakta)*

9. **A)** Është rrethuar numri *1. Hopkinsi* - ***1 pikë***

   **B)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse përshkruan ose perifrazon tekstin: "*Viti 1912 ishte vendimtar për zbulimin e vitaminave. Këtë vit së pari shkencëtari Hopkins e ka dëshmuar që për rritjen normale dhe zhvillimin e shtazëve nevojitet prania e disa përbërësve shtesë, përveç materieve organike themelore (lipideve, sheqerit, proteinave).* " *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

---

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

**10.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: *Me termin vitaminë dëshirohet të theksohet rëndësia e tyre për jetën dhe shëndetin e njerëzve. (dhe përgjigje tjera të sakta)*

**11. A)** *Procesi – **1 pikë***

**B)** *Franc Kafka – **1 pikë***

**12.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: *Absurdi në këtë vepër qëndron në faktin se kundër Mërsoit nuk ka ndonjë akuzë të përcaktuar, por përsëri dënohet për një krim të panjohur dhe nuk i lihet mundësia për t'u mbrojtur.*

***13.*** Është rrethuar numri *1. konflikti i individit dhe shoqërisë së kohës – **1 pikë***

**14.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: *Pjesa e errësuar na lë të kuptojmë se pa marrë parasysh rrethanat në të cilat ndodhej ende shihte shpresë dhe besonte në shpëtimin e tij.*

**15.** Është rrethuar numri *3. Krahasimit – **1 pikë***

**16.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse nga fjalia e dhënë ka përshkruar ose nënvizuar fjalinë e nënrenditur kohore: *Ndërsa po i mbante sytë mbyllur,*

**17.** Është rrethuar numri *3. habitore – **1 pikë***

**18. A)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse nga vargjet e dhëna ka përshkruar ose nënvizuar kohën e tashme të foljes: *Mblidhen*

**B)** Është rrethuar numri *1. veprim në vazhdimësi – **1 pikë***

**19.** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: *palatalizimi ose qiellzorizimi*

**20. A)** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse nga fjalia e dhënë ka përshkruar ose nënvizuar mbiemrat e shkallës krahasore: *më i qetë; më i heshtur.*

**B)** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse mbiemrat e shkallës krahasore i ka shkruar në shkallën sipërore: *shumë i qetë; shumë i heshtur*

**21. A)** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse ka caktuar saktë rasën e dy ose tre emrave të dhënë: *Amaranta – emërore; dhoma –emërore; e gjumit – gjinore*

**B)** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse ka shkruar saktë rasat e përemrave të nënvizuar: *tanë – gjinore; tonë – kallëzore*

**22.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse ka nënvizuar ose ka rrethuar dy ose tri konstatime të cilat kanë të bëjnë me letërsinë gojore: *2. krijimi individual; 3. epiteti i ngulitur; 5. fillimi dhe përfundimi stereotip* **(Vërejtje:** Nuk pranohet përgjigjja e saktë nëse me konstatimet e sakta i ka rrethuar edhe konstatimet e pasakta**)**

**23.** Është rrethuar numri *2. vetminë e paqetësueshme të një femre –* ***1 pikë***j

**24.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse ka shkruar: *Vargu tetërrokësh*

**25.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse ka shkruar: *Lokja simbolizon shkallën me peshën e dhembjes që të sjell jeta*

**26.** Nxënësi merr ***2 pikë*** për përgjigjen e plotë dhe të saktë të domethënies së fjalëve të veçuara nga teksti: *Shurdh a vendi – vetmi e plotë; tytë – e zbrazët, boshe; e reja - nusja*

Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse shkruan saktë domethënien e një ose dy fjalëve

**27.** Nxënësi merr ***2 pikë*** për përgjigjen e plotë dhe të saktë: *e shuemja – e mjera, e shkreta, e gjora; kjo fjalë mbart një ngarkesë të fortë emocionale, duke theksuar të mbeturit pa asgjë, pa njerëz, pa shpresë, vetëm të shuar nga jeta dhe dëshirat*

Nxënësi merr ***– 1 pikë*** nëse cakton saktë vetëm sinonimin e fjalës së dhënë ose tregon për ngarkesën emocionale që mbart ajo

**28.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** për shkrimin e saktë të titullit të veprës letrare dhe emrin dhe mbiemrin e autorit të saj:

1. *"I huaji", Albert Kamy -* ***(1 pikë)***
2. *"Lum Lumi", Ali Podrimja -* ***(1 pikë)***
3. *"Bagëti e bujqësia", Naim Frashëri -* ***(1 pikë)***

**29.** Nxënësi merr ***– 1 pikë*** për shkrimin e saktë të personazhit që i thotë vargjet e dhëna në veprën "Juda Makabe":

1. *Juda -* ***(1 pikë)***
2. *Janathas -* ***(1 pikë)***
3. *Prifti -* ***(1 pikë)***

**30. Skema për vlerësimin e esesë: Ky planet është i shenjtë**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi tregon:<br><br>- se gjendja e mjedisit jetësor sot është alarmante dhe se pasojat janë shqetësuese – gjithnjë e më pak ujë të pijshëm, vrimat e ozonit, hedhja e paligjshme e mbeturinave që janë të rrezikshme për jetën... *(dhe përgjigje tjera të sakta)* ***– 1 pikë***<br>- që prijësi i indianëve të Sietllit ia ka shkruar letrën në vitin 1854 presidentit të SHBA-ve Frenklin Pirs-it me qëllim që t'i tregojë për rëndësinë dhe vlerat e tokës *(dhe përgjigje tjera të sakta)* ***– 1 pikë***<br><br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi:<br>- perifrazon ose citon mendimin e prijësit të indianëve të Sietllit përse toka nuk mund të blihet dhe as të shitet ***– 1 pikë***<br><br><br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi kumton:<br>- që për njeriun e kuq toka është e shenjtë dhe se njeriu e ndan fatin e tokës *(dhe përgjigje tjera të sakta)* ***– 1 pikë***<br>- që për njeriun e kuq kafshët janë vëllezër dhe tregon për pasojat e zhdukjes së tyre ***– 1 pikë***<br><br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa** | Nxënësi perifrazon ose citon apelin dramatik të prijësit të indianëve |

| | |
|---|---|
| **4.** | të Sietllit për luftën për ekzistencë ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi thekson se lakmia është shtytësi themelor i raportit johuman i njeriut të bardhë ndaj mjedisit jetësor ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi tregon:<br><br>- për raportin e panjerëzishëm të njeriut të bardhë ndaj tokës të cilën e përjeton si ndonjë send tjetër ***– 1 pikë***<br>- për raportin jonjerëzor ndaj kafshëve të cilat i vret për argëtim ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 7.** | Nxënësi:<br>- shkruan si e përjeton letrën e prijësit të indianëve të Sietllit ***– 1 pikë***<br>- kumton gjykimin e vet për qëndrimet e prijësit të indianëve të Sietllit (origjinal, të përhershëm, universal...) ***– 1 pikë***<br><br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br>**Gjithsej 3 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil<br><br>**3 pikë**<br><br>origjinaliteti | respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, | lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve<br><br>**1 pikë** | përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)<br><br>**2 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale<br><br>**2 pikë** | renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale<br><br>**2 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave **r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br><br>**2 pikë**<br><br>**Gjithsej 4 pikë** | | |
| përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil | respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur** | | ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1 pikë** | **me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj.)<br><br>**1 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br>**1 pikë**<br><br>**Gjithsej 2 pikë** | | **1 pikë** |

**Skema për vlerësimin e esesë: "Porta e Ferrit" nga vepra "Komedia Hyjnore"**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi shkruan për:<br>- strukturën e "Komedisë Hyjnore" (ka strukturë të saktë simetrike që bazohet te treshi mistik) ***– 1 pikë***<br>- poemën që ndahet në tri pjesë, secila pjesë përmban 33 këngë ***– 1 pikë***<br>- elementin themelor poetik që është tercina ***– 1 pikë***<br>- subjektin e veprës (rrëfimi dhe vizioni i udhëtimit imagjinar i poetit në përtejbotë) ***– 1 pikë***<br><br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi shkruan për:<br>- personazhet e veprës dhe tregon rëndësinë e tyre (Beatriçen si mishërim të bukurisë hyjnore që bëhet engjëll që e shoqëron në Parajsë dhe Virgjilin si mësues ideal të pajisur me urtësi që e shoqëron në Ferr dhe Purgator) ***– 1 pikë*** |

| | |
|---|---|
| | *Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br><br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi shkruan për:<br>- vizionin e poetit për "përtejbotën" dhe udhëtimin e tij nëpër Ferr, ku digjen shpirtrat që nuk u udhëzuan nga arsyeja për jetën në Tokë ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br><br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi shkruan për:<br>- Purgator ku shpirtrat ende mund të pendohen dhe falen ***– 1 pikë***<br>- Parajsë ku mbizotëron dashuria e Perëndisë ***– 1 pikë***<br>- domethënien e fjalëve të gravuara mbi Portën e Ferrit ***– 1 pikë***<br><br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi shkruan për:<br>- gjendjen emocionale të poetit në momentet kur ndodhej para Portës së Ferrit (ndjenjën e frikës, mëdyshjen...) ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br><br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi shkruan për:<br>- mbështetjen dhe dorën që i ofron shoqëruesi i tij Virgjili për hyrjen në Ferr ***– 1 pikë***<br>*Nëse jep një përgjigje më me stil dhe më të plotë* ***– 1 pikë***<br><br>**Gjithsej 2 pikë** |

**Gjuha dhe forma e tekstit**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura ndërtimore e tekstit** |
|---|---|---|---|
| origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e | respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), e kongruencës, dallimi semantik i parafjalëve | lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve<br><br>**1 pikë** | përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike (ndan qartë hyrjen, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, fjalitë me stil<br><br>**3 pikë**<br><br>origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, hartimi nuk bazohet vetëm në ritregimin dhe përsëritjen e formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë me gabime minimale<br><br>**2 pikë** | **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij**, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit: **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj., mendimi i qartë dhe i përfunduar në fjali, renditja e saktë e fjalëve sipas sintaksës së gjuhës shqipe, përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale<br><br>**2 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave **r/ rr, dh/ ll, k/ q, s/ z, k/ g, ç/ q, gj/ xh, e/ ë**, shkrimi i saktë i numrave, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br><br>**2 pikë** | | shtjellimin dhe përfundimin; brenda shtjellimit ndan paragrafët)<br><br>**2 pikë** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **Gjithsej  4 pikë** | | |
| përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta, fjalitë pa stil<br><br>**1 pikë** | respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve **për** dhe **mbi**, përemrit **i vet/ i tij,** përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit **lidhur me këtë, duke marrë parasysh** dhe i përemrave: **që, i cili, e cila, të cilët** etj.)<br><br>**1 pikë**<br><br>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta<br>( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores **ë**, moszbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja **j**)<br>**1 pikë**<br><br>**Gjithsej  2 pikë** | | ndan qartë hyrjen, shtjellimin dhe përfundimin, por nuk i ndan paragrafët brenda shtjellimit<br><br>**1 pikë** |